

LIGJ
Nr. 113/2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pasqyra nr. 1, “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi” zëvendësohet me pasqyrën nr. 1 “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi” që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 1 korrik 2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.11.2021

Pasqyra nr. 1

Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura nga paga në lekë/muaj		E ardhura e tatueshme në lekë/muaj		Norma tatimore në përqindje/mujore
Nga	Deri në	Nga	Deri në	
0	40 000	0	40 000	0%
40 001	50 000	0	30 000	0%
		30 001	50 000	50% * 13% të shumës mbi 30 000 lekë
50 001	Më tepër	0	30 000	0%
		30 001	200 000	13% e shumës mbi 30 000 lekë
		200 001	Më tepër	22 100 lekë + 23% të shumës mbi 200 000 lekë